



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale / Direktorat za Zdravstvo i Socijalnu
Zaštitu / Department of Health and Social Welfare

Data: 24/04/2026

Nr. prot. 04-016/01-30877/26

Me qëllim të mbështetjes së nënave lehona, Komuna e Gjilanit ka vendosur të subvencionoj me nga 100 € (njëqind euro) për çdo lindje, për vitin fiskal 2026. Duke u bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit me numër 02-016/310, i dt. 20.04.2026 shpall këtë:

THIRRIJE PUBLIKE

Për aplikim për mbështetje financiare për nënat lehona banore të Komunës së Gjilanit, për të gjithë fëmijët e lindur nga data 01.01.2026 deri me datë 31.12.2026.

Kriteret e kualifikimit:

- Nëna duhet të jetë banore e përhershme e Komunës së Gjilanit
- Fëmija duhet të jetë i lindur nga data 01.01.2026 deri në ditën e aplikimit
- Fëmija duhet të jetë i lindur brenda territorit të Kosovës (në spitalin publik apo privat, në Gjilan apo qytete tjera, por jo jashtë shtetit).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Kopje të letërnjoftimit (për të dy prindërit)
- Ekstrakti i lindjes së fëmijës
- Çertifikata e vendbanimit
- Prindërit e kurorëzuar duhet të dorëzojnë çertifikatën e kurorëzimit, ndërkaq ata që nuk janë të kurorëzuar duhet të sjellin ekstraktet e tyre të lindjes
- Konfirmimin e xhirrologarisë bankare aktive të aplikuesit/paraqitësit të kërkesës në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës (njëri nga prindërit)
- Aplikimi bëhet përmes dorëzimit të kërkesës në Qendrën për Shërbime me Qytetar (QSHQ)

Aplikacionet do të shqyrtohen për lindjet e reja nga muaji Janar 2026 deri në fund të vitit 2026.

- **Afati i fundit për aplikim është data 31.12.2026**

Vërejtje:

- Dokumentet duhet të dorëzohen në origjinal apo kopje të noterizuara, përveç kopjes së letërnjoftimit
- Të dhënat e aplikuesit në çertifikatën e vendbanimit dhe në letërnjoftim, duhet të përputhen me njëra-tjetrën :
- Aplikuesit që nuk e dorëzojnë njërin nga dokumentet e cekuar më lartë diskualifikohen nga subvencionimi.

Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Mimoza Kadriu Qerimi

Komuna e Gjilanit | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Gjilan 60000 | Republika e Kosovës
<https://kk.rks-gov.net/gjilan/>

